

**Duart larg nga ligji i punës**

**Punë e shëndetshme dhe jetë më të mirë!**

**2**



**Shoqëri civile solidare në Greqi**

**Klinikat dhe kuzhinat e solidaritetit në Selanik**

**3**

**Marrëveshja mbi sigurimet shoqërore Zvicër – Kosovë**

**Informimi i të prekurve është një domosdoshmëri urgjente**

**4**

Nr. 4 | korrik 2017 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

**Revidimi i ligjit për përfitime suplementare**

## Të mos kursehet tek ata, të cilët nuk kanë çka të kursejnë



Personat në moshë përballen me shpenzime të mëdha për të mbuluar nevojat jetësore

**Këshilli federal i përfaqësuesve të kantoneve në këtë seancë trajton revidimin e përfitimeve suplementare. Parashtrësia ligjore përmban propozime të mira siç është rasti i përshtatjes së maksimës së qerasë, mirëpo edhe përkeqësime pa kurrfarë ndjesie sociale.**

Rreth 300 000 të moshuara dhe të moshuar si dhe njerëz me aftësi të kufizuara dhe me nevoja të veçanta, sot janë të varur nga përfitimet suplementare (në tekstin e mëtejshëm: PS / EL), për ti përballur shpenzimet jetësore. Dhe numri i tyre sa vjen e rritet. Pasi të ardhurat nga pensionet në raport me shpenzimet jetësore janë duke çaluar. Andaj është me rëndësi që të përmirësohen pensionet. Revidimi i sigurimit të pensioneve 2020 e bënë këtë. Përmirësimi i pensioneve të pleqërisë për 840 franga, gjegjësisht deri në 2712 franga për çiftë bashkëshortore, si dhe adaptime në sigurimin e detyrueshëm profesional, do të forcojnë të ardhurat e pensioneve për njerëz me paga të ulëta. Këto përmirësime janë urgjente. Aq më shumë habit fakti se revidimi i ligjit federal për përfitimet suplementare tek sigurimi i pleqërisë, trashëgimtarëve dhe invaliditetit, parashih kursime prej rreth 300 milion frangave. Këto masa kursyese do të vërejnë më së shumti të gjithë ata që nga PS merr edhe kompensimin për premitë e sigurimit shëndetësor.

Këshilli federal i përfaqësuesve të kantoneve do të shqyrton revidimin e ligjit të PS në seancën verore.

Parashtrësia përzien të mirën dhe të keqen. Rritja e maksimës së qerasë tek përllogaritja e PE është diç urgjente, e kërkuar të përshtatet qysh moti nga Bashkimi i Sindikatave të Zvicrës. Përkeqësimet, si fjala bie shkurtimi i kufirit të pasurisë së lejuar dhe shkurtimi i pagave minimale të PS megjithatë do të godasin rëndë pranuesit e PS.

**Të mos kursehet tek kompensimi**

Edhe më shumë vlen kjo për kthimin e premive të sigurimeve shëndetësore. Aktualisht pranuesit e PS marrin mbrapsht premitë e sigurimeve shëndetësore në lartësinë e mesatares së premive në kantonin e tyre. Në të ardhmen parashihet mbulimi i kthimit në lartësinë e kompensimit të premive më të larta individuale të Kantonit. Ky propozim i heq pranuesve të PS rreth 120 milion franga në vit. Komisioni i këshillit federal të dhomës së kantoneve nuk mjaftohet me kaq, por dëshiron që të ndryshojë baza e llogaritjes.

Shumica e anëtarëve të komisionit kërkon që si bazë për llogaritjen e PS në të ardhmen, të llogaritet shuma paushallë në lartësinë e premisë së

sigurimit shëndetësor të tretë për kah madhësia në Kanton. Kështu pranuesit e PS duhet të ngazëlleshin që mundësisht të sigurohen sa në lirë. Pakica e anëtarëve të komisionit ngul këmbë në propozimin e qeverisë, i cili mbështet në shumën paushallë të Kantonit, gjegjësisht të premisë mesatare regjionale.

Propozimi i shumicës së komisionit kufizon shumë lirinë e pranimit të PS për të përzgjedhur ofruesin e sigurimit shëndetësor. Në kantone të veçanta nuk ekzistojnë tri sigurime shëndetësore për ti përzgjedhur, e të cilat janë më të favorshme se premitë mesatare.

**Të mos atakohen më të dobët**

Pos kësaj nuk do të funksionojë nxitja për të ndërruar sigurimin e shëndetësisë më të favorshëm tek pranuesit e PS:

- Para së gjithash për pranuesit e PS, të cilët janë të varur kohë të gjatë nga përkujdesja, ndërrimi i sigurimit shëndetësor nuk është i mundur të bëhet nga vet ata. Ata janë të varur nga mbështetja e anëtarëve të familjes apo këshillimoreve.

- Pranuesit e PS posedojnë shumë pak mjete personale. Andaj ata janë të varur që arkat e sigurimeve shëndetësore të bëjnë pagesat e faktuarave të mjekëve dhe barërave shpejtë dhe pa komplikime. Siguri-

met shëndetësore me premitë më të ulëta nuk posedojnë shërbime të mjaftueshme dhe zvarritin kthimin e mjeteve të kompensimit.

Andaj ndërrimi në arka më të lira shëndetësore për pranuesit e PS ka si pasojë edhe kufizime financiare. Përqendrimi i pranuesve të PS tek Arkat e sigurimeve shëndetësore më të lira në një kohë të shkurtë do të qonte në rritjen e premive. Pasi rrezikimi strukturor i këtyre të siguruarve shëndetësor do të ndryshonte në mënyrë të pafavorshme. Në të njëjtën kohë përmes ndërrimit të akrove të sigurimit shëndetësor do të intensifikohet ndërlikimi administrativ për të gjithë të siguruarit shëndetësor.

Bashkimi i Sindikatave të Zvicrës është kundër kësaj nxitjeje kursyese të rreme në kurriz të pranuesve të PS. Kjo nuk do të kishte domethënie tjetër, porse një mënyrë tjetër e kompensimit të një pjese të vogël të shpenzimeve shëndetësore përmes PS. Shpenzimet e shumuara do të duhej kursyer nga nevojat e përgjithshme jetësore. Një sulm i tillë karshi atyre që edhe ashtu janë të dobët nuk është i pranueshëm. Në përputhje me këtë Bashkimi i Sindikatave të Zvicrës ka intervenuar tek Këshilli federal i përfaqësuesve të kantoneve.

**Doris Bianchi**, drejtues e sekretariatit në SGB/US, përgjegjëse për sigurimet shoqërore dhe politikave për të moshuar

### Editorial



**Të dashur/a lexues/e**

Përfitimet suplementare (PS) janë nën presion: Andaj më se urgjente përmirësimet e pensioneve

Nëse pensionet shoqërore të pleqërisë AHV/IV (AVS/AI) si dhe ato të arkës profesionale të pensioneve nuk mjaftojnë për të mbuluar shpenzimet jetësore, atëherë vijnë në shprehje përfitimet suplementare (EL / PC). Ato mbyllin hendekun mes pensioneve të ulëta dhe sigurimit të ekzistencës. Pos kësaj PS, krahas AHV/AVS janë shndërruar në sistem zvicëran të financimit e përkujdesjes. Ato mbulojnë shpenzimet e larta të shtëpive të kujdesit për pleqtë. Kështu PS mënjanojnë tek nevojtarët e përkujdesjes deri tek shtresa e mesme shoqërore rrëshqitjen në asistencë sociale apo kërkimit të mbështetjes familjare. Ky financim i rëndësishëm socio-politik i qëndrimit në shtëpi pëlqesh dhe përkujdesjeje, duhet të mbrohet.

Ndryshe nga përfitimet e sigurimeve, të cilat në rast të rrezikut automatikisht ndodh pagesa, ndërsa përfitimet suplementare duhet të kërkojnë. Si përfitim nevojtar PS ndodh vetëm në rast të dëshmisë nevojtare. Këto janë të ndërlihdura me pengesa administrative dhe shpesh edhe me turpërim. Në Zvicër janë 320 000 të moshuar/a si dhe njerëz me aftësi të kufizuara, të cilët kanë nevojë për PS. Nga këta veçanërisht janë të prekura gratë dhe migrantët.

Aktualisht PS janë nën presion të politikës. Pasi rritja e madhe e shpenzimeve nga PS dëshirohet të përballohet me masa kursyese. Revidimi aktual i Ligjit për PS që është në shqyrtim në parlament, në njërin anë dëshiron që të mbyllë qasjen në PS, në anën tjetër dëshiron që të redukton lartësinë e përfitimit. Qeveria dhe parlamenti nisen nga një potencial kursyese deri në gjysmë miliard frangash. Para këto, që do tu mungojnë nevojtarëve për PS.

Në këto rrethana është veçanërisht e rëndësishme, që të përmirësohen të ardhurat nga pensionet e punëmarësve me të ardhura të ulëta. Ashtu si është paraparë në sigurimin e pensioneve 2020, për të cilën do të votohet me 24 shtator 2017. Pensioni më i lartë i pleqërisë dhe përmirësimi i të ardhurave nga pensionet profesionale obliguese reduktojnë varësinë nga PS. Ky është një përparim i madh socio-politik. Pasi përfitimet nga pensionet është më i sigurtë dhe më i denjë se sa PS.

**Doris Bianchi**

## News

**Shkarkime masive tek Bombardier**

Koncerni kanadez Bombardier ka paralajmëruar së fundi reduktimin e 650 vendeve të punës. Të prekur janë para së gjithash vend punishtja në Villeneuve (VD), mirëpo edhe Cyrihu. Unia bashkë me personelin do të angazhohet aktivisht për ruajtjen e mundshme të gjitha vendeve të punës. Koncerni kanadez është duke zhvilluar një ristrukturim të gjithë sektorit të tij transportues. Qysh në vitin e kaluar pushoi nga puna 70 veta në Zvicër. Tani në gjithë Zvicrën ka të punësuar 1300 persona.

Unia së bashku me të punësuarit dhe përfaqësuesit e personelit do të angazhohet, që të ruhen sa më shumë vende të punës, ti mbrojtë të drejtat e të punësuarve dhe të përpunohet një strategji e qëndrueshme për të ardhmen.

**41 shkarkime tek firma pastruese e FIFA-s**

Pasi FIFA ka anuluar kontratën me firmën e saj pastruese, që nga fundi i korrikut 2017 do të hedhen në rrugë 41 gra. Gratë kërkojnë marrjen përsipër të kontratës së tyre të punës nga ana e FIFA-s Firma «SCJ Personal Service AG» nga fundi i korrikut 2017 humbë mandatin e saj të vetëm për mirëmbajtjen e selisë qendrore të FIFA-s në Cyrih. Gjithsej 41 nga 60 të punësuarit humbin vendet e tyre të punës. Të gjithë të prekurit nga shkarkimet janë gra. Të 20 kolegët e tyre burra do të vazhdojnë të jenë të punësuar më tej nga FIFA në zonën e objektit. Gratë kërkojnë mbështetje nga Unia, që marrëdhënia e tyre e punës gjithashtu të merret përsipër nga FIFA, apo nga firma e mundshme pasuese.

**Givaudan: Më shumë pagë falë kërcënimit për grevë**

Përmes një kërcënimi me grevë, të punësuarit tek prodhuesi i aromave dhe shijeve nihatëse Givaudan të Gjenezës kanë arritur të rritin pagat e tyre për 1,5% dhe përmirësime tjera në Kontratën Kolektive të Punës. Kah mesi i majit mbledhja e vizituar mirë nga të punësuarit, refuzoi praktikisht njëzëri propozimin e drejtorisë. Në të njëjtën kohë ata kërcënuan me grevë, nëse drejtoria nuk merre parasysh kërkesat e tyre. Kjo tregoi ndikim: Tani drejtoria e Givaudan u pajtua që pagat e sivjetme të rriten për 1,5%, ndërsa në vitin 2018 për 1,2% për të gjithë. Pos kësaj kohëzgjatja maksimale e marrëdhënies së punës për të punësuarit temporal u shkurtua nga 3 në 2 vite si dhe përfitimi për premitë e arkave të sigurimit të shëndetësive u rrit nga 200 në 220 franga. KKP e re vlen deri në vitin 2020; asaj i nënshtrohen 300 të punësuar.

**Puna e shëndetshme – jeta e mirë**

# Duart larg nga ligji i punës!

**Punëmarrësit në Zvicër duhet të punojnë gjithnjë e me gjatë dhe të jenë edhe më fleksibil. Parlamentarët/et e djathtë/a borgjez/e kanë vu në shënjestër ligjin e punës. Ata/o duan që heqin obligimin për të evidentuar orët e punës dhe të heqin kontrollin e orarit të punës. Kështu janë të para programuara mbingarkesat dhe burnoti. Unia kundërshton këtë me të gjitha mjetet kundër këtyre parashtresave parlamentare të rrezikshme dhe të dëmshme për shëndetin.**

**Presioni i kohës dhe oraret e stërzgatura të punës shkaktojnë stres**

Unia rregullisht përballlet me pyetjet dhe rastet vijuese:

«Bashkëshortja ime punon me orar të plotë në gastronomi dhe në ditë ka vetëm 5 minuta pauzë dreke. Ajo rregullisht bënë orë të tepërta pune. Shkaku i stresit në punë ajo ka probleme shëndetësore.»

Temat mbi orarin e punës dhe stresin profesional i preokupojnë shumë të punësuarit. Këtë e tregon edhe linja e shërbimit telefonik të Unias mbi orarin e punës (e arritshme

në [www.service-arbeitszeit.ch](http://www.service-arbeitszeit.ch), apo 0848 240 240). Që presioni ndej të punësuarve është duke u rritur vërteton qartë edhe studimi i ri mbi kushtet zvicerane të punës në krahasim me ato evropiane (studimi EWCS): Mbi 60% e të anketuarve pohojnë se punojnë nën presion të lartë të kohës dhe presion terminësh. Pos kësaj edhe orari i punës në Zvicër është më i gjati në Evropë (Zvicër: 42 orë, Evropë: 39 orë). Në të njëjtën kohë është duke u reduktuar pjesëmarrja në ndërmarrje sa i përket rregullimit të kushteve të punës.

Puna e tej zgjatur, puna gjatë kohës së lirë dhe mungesa e planifikimit

dëmton shëndetin. Më shumë se 1/3 e të anketuarve në studimin e EWCS në fund të ditës janë të rraskapitur. Unia është e alarmuar nga shkalla e lartë e rraskapitjes. Mbrojtje me rëndësi kundër mbingarkesës dhe burnotit janë regjistrimi i orëve të penës si deh rregullat mbrojtëse si për orarin maksimal të punës dhe respektimi i pushimeve.

**E djathta nisë sulmin kundër rregullimit të orarit të punës dhe ligjit të punës**

Tani e djathta në parlament atakojnë frontalisht mbrojtjen shëndetësore të punëmarrësve. Para së gjithash kohëmatjen e orëve të punës dhe orët e rregullta të punës për ta janë si kripa në sy. Bazuar në iniciativën e këshilltares federale nga dhoma e kantoneve Keller-Sutter do të përjashtohen me qindramijëra punëmarrës nga kohëmatja e orarit të punës. Këshilltari tjetër federal Konrad Graber dëshiron pos kësaj që për grupe të caktuara të eliminojë krejtësisht orarin maksimal të punës, si dhe të heq nga rendi i ditës ndalesën për punë natën dhe të dielave. Zhdukja e masave mbrojtëse qon në punë falas dhe shfrytëzim dhe i shërben në fund të fundit vetëm punëdhënësve.

Nëse nuk vlejnjë më tej orari maksimal i punës, vuan jo vetëm shëndeti, por edhe pajtueshmëria e profesionit me familjen. Nëse punëmarrësit duhet të jenë në dispozicion më shumë se sa 50 orë në javë, kjo personat me obligime familjare i venë para problemeve të mëdha apo edhe u pamundëson atyre që të kryejnë profesione të caktuara. Duhet pritur gjithashtu edhe dështime masive nga fusha e barazisë dhe integritimit të grave në tregun e punës.

**Unia kërkon zgjerimin në vend të reduktimit të mbrojtjes së shëndetit**

Të punësuarit kanë nevojë për një ligj pune, i cili ofron mbrojtje nga keqpërdorimi. Për të marrë parasysh ngarkesat e punëmarrësve duhet që të mos reduktohet mbrojtja e shëndetit por që ajo të rritet. Unia kërkon më shumë kontrolle dhe rregullim më të mirë të orarit të punës edhe përmes Kontratave Kolektive të Punës. Unia ka nisur një fushatë me titullin «Duart larg nga ligji i punës» dhe do të kundërshton me të gjitha mjetet parashtresat parlamentare të rrezikshme dhe të dëmshme për shëndetin.

Christine Michel, sekretare në Unia, eksperte për mbrojtjen e shëndetit dhe siguri në punë

**Çka është shërbimi i orarit të punës?**

Qendra profesionale këshillon të gjithë personat e interesuar me kompetencë dhe pa pagesë në lidhje me çështjet rreth orarit të punës. Ju mund të lajmëroheni përmes lidhjes të pandërprerë telefonike 0848 240 240 ose përmes formularin kontaktues në [www.service-arbeitszeit.ch](http://www.service-arbeitszeit.ch).

**service-arbeitszeit.ch**  
**0848 240 240**

**Lëvizja e lirë i personave dhe masat shoqëruese**

# Mjedisi i vështirë kërkon instrumente shtesë

**Masat shoqëruese janë të arritura të rëndësishme për mbrojtjen e pagave dhe kushteve të punës. Shkaku i hapësirës ekonomike së ndryshueshme presioni në paga është rritur. Në përputhje me këtë duhet të përshtaten dhe të përmirësohen masat shoqëruese. Nevojiten më shumë paga minimale, instrumente më të mira kundër shtypjes së pagave, kufizimi i zinxhirit të nën-kontraktuesve dhe zgjerimi i kontrolleve.**

Futja e lëvizjes së lirë të personave në vitin 2002, parë nga vështrimi i politikave të migracionit ishte një përparim i rëndësishëm, pasi kjo i dha fund statutit jo të denjë të punëtorëve stinorë si dhe ju garanton migrantëve nga vendet e BE-së më shumë të drejta. Për sindikatën

Unia është e qartë: Në Zvicër duhet të vlejnjë pagat zvicerane.

**Më shumë presion në paga**

Presioni në tregun e punës është rritur. Përdërisa në Zvicër industria e ndërtimit është duke lulëzuar, veprimtaria ndërtimore në shumë

vende të Evropës është duke çaluar. Rreziku që punëdhënës të paskrupull të punësojnë njerëz me paga dumpingu është rritur. Shpesh janë nënkontraktuesit ata që punojnë me punëmarrës, të cilët punojnë më pak se 90 ditë në Zvicër, në ndërkohë që nga viti 2005 është trefishuar.

**Më shumë parashtresa**

Kuotat e shkeljeve edhe më tej janë shumë të larta. Komisionet e paritetit në 30% të kontrolleve zbulojnë shkelje, ndërsa tek kantonet kjo kuotë nga 9% në vitin paraprak është rritur në 12%. Sektorët e reziquar janë ndër të tjerë tregtia me pakicë, kopshtaria, siguria, ndërtimtaria, personeli i huazuar si deh industria.

**Stop dumpingut në paga**

Andaj nevojiten më shumë paga minimale, së paku në Kontrata Normale të Punës. Të nevojshme janë gjithashtu përmirësimet në rrafshin e kontrolleve. Pos kësaj nevojiten edhe instrumente shtesë, për të pasur mundësi kantonet që në rast të dyshimit për dumping në paga, t'ua ndërpresin punën ndërmarrjeve në fjalë. Kjo shpesh është mjeti i vetëm, për të ndaluar dumpingun në paga që bëjnë nënkontraktuesit. Në lëmin e punësimit publik duhet që federata, kantonet dhe komunat të kontrollojnë në mënyrë konsekuente, se kujt i epen mandate dhe kështu të parandalojnë nënkontraktuesit. Pos kësaj nevojitet përfundimisht një regjistër i firmave ofertuese korrekte.



Pamje nga një aksion sindikalist në Cyrih kundër dumpingut në paga

## Peticioni i kujdesit

# Qeverisë federale i dorëzohen 10 000 nënshkrime

Më 30 maj 2017 në konferencën e Unia-s nga sektori i përkujdesjes për të moshuar kanë marrë pjesë mbi 50 pjesëmarrës. Të pranishmit kanë kërkuar kushte më të mira pune për përkujdesjen afatgjate dhe kompensim korrekt të shërbimeve të kujdesit. Ata i kanë dorëzuar qeverisë federale peticionin «Kujdesi dhe mbështetja e mirë kanë nevojë për kushte të mira pune».

Sektori i kujdesit privat është duke lulëzuar. Orpea, njëri nga ofertuesit më të mëdhenj të shtëpive për të moshuar, që nga maji 2016 është rritur për 60 shtëpi pleqsh në tërë Evropën. Këtë e ndriçojnë këshilltari shkencor Karol Florek. Zvicra nuk është më e madhja, por në tersi tregu më përfitues për Orpea (51,4 milion Euro fitim operativ vetëm në vitin 2016). Orpea është shoqata amë e shtëpive zvicerane për të moshuar «Schweizer Senevita-Heime». Qysh në vitin 2016 Orpea bleu SpiteX-in zviceran «SpiteX Ville et Campagne». Florek tregon se si i minimizon ndërmarrja shpenzimet edhe në Zvicër: Ajo angazhon fuqi të lirë dhe të zëvendësueshme punëtore si dhe investon në pamje të shtëpive dhe patundshmëri përfituese, në vend se në kushte të mira pune.

## Dinjtet njerëzor në vend të grykësisë përfituese

Në mesin e majit Unia ka nisur një aksion përmes E-maileve protestues tek Senevita dhe ka kërkuar që më në fund të evitohen problemet në shtëpitë e pleqve dhe që mirëqenia e banorëve në to si dhe personelit kujdestar mos ti nënshtrohet grykësisë përfituese. Në aksionin protestues online kanë marrë pjesë rreth 150 persona. Kësaj duhet shtuar edhe mbi 400 kartolina protestuese

me të njëjtat kërkesa. Deri më tani ka munguar reagimi nga drejtorja e ndërmarrjes.

## 10 000 nënshkrime për qeverinë federale

Në një aksion përmbyllës të pranishmit i dorëzuan zyrës federale peticionin e iniciuar vitin e kaluar «Kujdesi dhe mbështetja e mirë kanë nevojë për kushte të mira pune» me mbi 10000 nënshkrime. Pasi edhe politika është përgjegjëse. Kërkesat konkrete janë: personel dhe mjete të mjaftueshme; respektimi i jetës private; mirënjohje për shërbimin dhe kontributin punues; më shumë kohë për përkujdes; KKP më të mira; marrëdhënie të sigurta pune.

## Të investohen në njerëz, në vend se me maksimizuar fitimet

Nevojiten veprime urgjente për kushte më të mira pune në sektorin e kujdesit. Andaj Unia ka iniciuar fushatën informuese «Të investohen në njerëz, në vend se me maksimizuar fitimet». Pasi nga investimet në njerëz përfitojnë të gjithë. Dhe në vend të orientimit përfitues maksimizues nga zinxhirët multinacional, duhet që në qendër të vëmendjes të vihet njeriu. Qoftë në raport me personelin kujdestarë dhe mbështetës, qoftë në raport me nevojtarët për përkujdesje apo familjarët e tyre: Fjala është për dinjtetin e personelit të përkujdesjes dhe kujdestarëve dhe të njerëzve që kanë nevojë për përkujdesje e mbështetje. Për Unia-n dhe anëtarët e saj nga sektori i përkujdesjes dhe mbështetjes është e qartë: Kështu nuk guxon të vazhdohet më tej. Politika dhe punëdhënësit kanë përgjegjësi dhe ata duhet më në fund të veprojnë.

Emine Sariaslan



Pamje nga dorëzimi i peticionit të personelit për kujdesin për të mosharët

## Konferenca e migracionit të Unia-s

# Të drejta të njëjta për të gjithë

Konferenca për migracion e Unia-s e datës 13.05.2017 në Bernë kërkoi njohjen e personave e pa letra (Sans-Papiers) në Zvicër dhe u angazhua fuqishëm për preokupimet e migrantëve të Zvicrës përmes strategjisë së Unia-s 2020.

Në Zvicër jetojnë e punojnë mes 80000 dhe 200000 persona pa letra. Unia ka kohë që kërkon të ndërmerren hapa për rregullimin e lejeve të tre të qëndrimit.

së Unia-s 2020. Kjo konferencë fuqizojë qëndrimin që sindikata Unia si organizata më e madhe e migrantëve /eve të Zvicrës do të mbrojë edhe më tej të drejtat e migrantëve.

Për këtë duhet të bëhen përpjekje që migrantët që kanë ardhur rishitas në Zvicër të pranohen në sindikatë.

Unia-Medienmitteilung



Pamje nga konferenca e migracionit të Unia me 13 maj 2017

## Gjeneva si shembull i mirë

Kantoni i Gjenevës paraprinë në këtë çështje. Përmes pilot projektit «Papyrus», në të cilin janë të përfshira autoritetet zyrtare dhe organizatat e shoqërisë civile, Sans-Papiers do të marrin një leje qëndrimi dhe kështu ata kanë mundësi të kërkojnë të drejtat e tyre. Konferenca e migracionit të Unia-s kërkon nga autoritetet e komunave dhe kantonëve të Zvicrës të ndjekin shembullin e Gjenevës.

## Të fuqizohet Unia si organizata më e madhe e migrantëve/eve

Konferenca e migracionit të Unia-s diskutoi edhe zbatimin e strategjisë

## Intervistë



Bruna Campanello

## Shoqëri civile solidare në Greqi

Komisioni profesional evropian i grave të Bashkimit të Sindikatave Internacionale të ndërtimit dhe drurit (BHI) u takua në Selanik të Greqisë, nga data 25-27 maj 2017. Unia ishte e përfaqësuar ndër të tjera edhe nga Bruna Campanello, anëtare e sektorit të tregtisë. Horizonte ka biseduar me te.

Bruna, në Selanik sindikalistet/ët nga vende të ndryshme të Evropës kanë diskutuar mbi preokupimet e grave për Kongresin e BHI-së që do të mbahet në nëntor 2017. Përndryshe çka keni bërë tjetër?

Ne kemi vizituar kampin e refugjatëve Diavata, jemi ushqyer me specialitete italiane në një kuzhinë solidariteti si dhe kemi vizituar klinikën e solidaritetit. Ne patëm gjithashtu rastin të takojmë edhe përfaqësues të qeverisë Tsiparis, të cilët na dhanë një pasqyrë të situatës sociale e ekonomike të Greqisë.

### Si e ke përjetuar ti kampin e refugjatëve?

Ai është hapur në vitin 2006, atëkohë aty jetonin 25000 njerëz. Sot aty janë rreth 300 persona nga Siria, Afganistani e Iraku. Fillimisht refugjatët jetonin në tenda, sot atyre u janë vure në dispozicion kontejner me kuzhina të montuara. Ka edhe dhoma ndeje vetëm për gra dhe fëmijët (e tyre), ku mund të qepin dhe të zhvillojnë aktivitete tjera. Gjithashtu aty ka edhe në shkollë. Fëmijët vijnë mësimin në mëngjes, ndërsa pasditë vijnë shkollën «publike». Ajo çka më pëlqeu ishte se njerëzit mund të lëvizin lirshëm, domethënë se nga kampi i refugjatëve, i cili është rreth 10 kilometra larg Selanikut, njeriu mund lirshëm të largohet.

### Ka edhe disa përmirësime...

Nisur nga fakti se shumica e njerëzve kanë pas veti një arratisje traumatike, ata janë të pranuar relativisht mirë. Ata kanë sferën e tyre private dhe mund të lëvizin lirshëm. Greqët edhe përkundër vështirësive të tyre materiale, megjithatë janë dukë ndërmarrë masa për përmirësimin e situatës. Kështu refugjatët sipas mundësisë vendosen edhe në banesa të qytetit. Kjo paraqet shanse të mira për ta, pasi ata kështu largohen nga kampi dhe mund të integrohen në jetën «normale». (Kështu shfrytëzohen në mënyrë kuptimplote banesat e mbetura bosh). Mirëpo ne nuk kemi arritur ende aty ku dëshirojmë. Këta njerëz kanë qenë të detyruar të arratisen dhe nga pikëpamja ime kanë të drejtë të arrijnë vendin e tre të synuar në Evropë dhe të trajtohen shumë mirë. Për këtë duhet të angazhohemi të gjithë ne.

### Çka janë klinikat solidare dhe kuzhinat solidare?

Klinikat dhe kuzhinat e solidaritetit janë Institucione, të cilat janë ndërtuar dhe edhe udhëhiqen nga vullnetarë: Në klinikën, të cilën e kemi vizituar, punojnë rreth 200 vullnetarë dhe ata përkujdesen për 15000 pacient/e në vit. Klinikat janë ndërtuar, pasi njerëzit kanë humbur të drejtën për përkujdesje shëndetësore publike. Shoqëria civile nga nevoja është vetorganizuar. Tani kanë të gjithë kanë të drejtë në përkujdesje publike shëndetësore, pas ndryshimit të ligjit në vitin 2015. Mirëpo klinikat solidare kryejnë ehe më tej shërbime shumë të çmuara. Kuzhinat solidare gatujnë për njerëzit, të cilët nuk kanë mundësi të sigurojnë ushqime të ngrohta dhe ato janë të hapura për të gjithë. Këtu njerëzit mund të takohen dhe të shkëmbejnë. Ekziston një lëvizje solidariteti në Greqi, nga njerëz që zbatojnë aktivisht dhe praktikisht gjera të vogla dhe të mëdha. Kjo më ka lënë përshtypje të thellë.

### Si ishte takimi me përfaqësuesit e qeverisë?

Shumë interesant. Qeveria Tsiparis përpiqet të përmirësoi jetën e njerëzve. Ajo investon në infrastrukturë, kundërshton privatizimet, nxitë lëvizjet sociale dhe fuqizon lëmin shëndetësore. Siç ndodh shpesh, ata luftojnë me imazhin e tyre. Pasi mediat e djathta (edhe në Evropë) raportojnë vetëm për negativën dhe BE-ja i detyron të kursejnë edhe më shumë. Dha ajo që është e qartë, në Greqi nuk ka më shumë çka që mund të kursehet.

### Cilat përshtypje i ke marr ti me veti?

Më ka përforcuar bindjen time, se sindikalistet dhe sindikalistet nuk duhet të shohin anash, se çka ndodh në kufi deh ne nuk duhet të solidarizohemi vetëm formalisht. Ne duhet aktivisht të japim kontributin tonë, që njerëzve në ikje tu ofrojmë e krijojmë një vend korrekt dhe të barabartë në shoqërinë tonë. Kjo, jo vetëm për arsye humanitare: refugjatët e sotëm janë punëmarrësit e nesërm. Nëse nuk jemi vigjilent, do të kemi pasojat e përkeqësimit dhe shfrytëzimit të të gjithë punëmarrësve.

Marília Mendes

Dritëhijet e marrëveshjes mbi sigurimet shoqërore mes Zvicrës dhe Kosovës

# Informimi i personave të prekur – domosdoshmëri urgjente

Nënshkrimi i marrëveshjes në mes të grupeve teknike negociuese në Bern ma 1. qershor 2017 është pa dyshim gurëthemeli i parë dhe më i rëndësishmi nga pavarësia e Kosovës për mërgimtarët nga Kosova në Zvicër. Me hyrjen e saj në fuqi, pas procedurave ratifikuese të dy vendeve përkatëse, garantohet trajtimin e barabart i kontributpaguesve Kosovar në Zvicër në raport me shtetasit tjerë në Zvicër si dhe në raport edhe me shtetasit e shteteve fqinje të Kosovës. Siguria Shoqërore me këtë Marrëveshje nënkupton të drejtën e eksportimit të pensioneve në Kosovë si dhe mbulesën e shpenzimeve si pasojë e rreziqeve sociale pavarësisht vendbanimit apo vendit të ushtrimit të një aktiviteti ekonomik.



Aksioni me rastin e dorëzimit të peticionit në Bernë

Riaktivizimi i zbatimit të marrëveshjes me ish Jugosllavinë, i ndërprerë para mbi shtatë viteve, duke marrë parasysh arrijten e marrëveshjes është i domosdoshëm, i arsyeshëm dhe i drejtë.

## Arsyet e ndërprerjes së marrëveshjes

Arsyet e ndërprerjes së zbatimit të marrëveshjes me ish Jugosllavinë në raport me Kosovën nuk ndërlidhen me keqpërdorimet, siç mendohet në vazhdimësi, pasi që për keqpërdoruesit individual, pavarësisht prejardhjes së tyre, janë zbatuar, zbatohen dhe me të drejtë do të zbatohet edhe në të ardhmen dispozitat ndëshkuese të legjislacionit në fuqi dhe shteti ligjor nuk lejon ndëshkime kolektive.

Zvicra zyrtare si arsye ka theksuar në rend të parë vështirësitë serioze në zbatimin e saj nga organet zbatuese të Kosovës, ndërsa arsye jozyrtare ishte padyshim qëllimi i autoriteteve Zvicerane për të implementuar edhe në marrëveshjet me shtetet tjera të dala nga ish-Jugosllavia dispozitat ligjore për luftimin e keqpërdorimeve në sigurimin e invaliditetit, të cilat edhe janë integruar në marrëveshjet e reja. Për këtë qëllim mund të jetë përzgjedhur Kosova dhe brishtësinë e saj institucionale, bashkë me situatën e paqartë dhe komplekse të pushteteve të ndryshme (UNMIK, EULEX, administratorët ndërkombëtarë, vendorët dhe pretendimet kolonialiste të Serbisë) dhe (mos)përgjegjësi të tyre. Mirëpo në këtë rast asesi nuk duhet harruar motivin faktik politik, që dëshmohej përmes parashtrësve parlamentarë të Partisë Popullore të Zvicrës të shoqëruara para dhe pas me fushatë perfide, e cila ka detyruar qeverinë federale të Zvicrës që fillimisht të merre vendimin për mos zbatimin e marrëveshjes së trashëguar në fjalë në raport vetëm me Kosovën.

Me nënshkrimin e marrëveshjes tanimë në njërin anë Zvicra ka arritur qëllimin e saj duke inkorporuar këto dispozita në marrëveshjet ndërshtetërore me shtetet fqinje të Kosovës ndërsa në anën tjetër Kosova ka dëshmuar nivelin e domosdoshëm për zbatimin e marrëveshjes.

## Ish sezonierët kanë pësuar më së shumeti

Siguria Shoqërore e gjeneratave nuk fillon as nuk përfundon në një datë të caktuar pavarësisht vendimeve të autoriteteve të një shteti. Me ndërprerjen e vazhdimet të zbatimit të marrëveshjes me ish Jugosllavinë nga 1 prill 2020 për mbi shtatë vite kanë pasuar më së shumeti pjesa e mërgatës e cila padyshim ka kontribuar më së shumeti në zhvillimin e sigurisë shoqërore në Zvicër, në mirëqenien ekonomike e sociale në Kosovë e në Zvicër, si dhe në fazat më delikate të historisë së Kosovës. Shumë nga këta mërgimtarë nga Kosova kanë qenë detyruar të kthehen në Kosovë, kryesisht me vendimin nga Zvicra për përfundimin e rekrutimit të punëtorëve nga ish Jugosllavia në nga viti 1996 e në vazhdim. Ata tanimë ose i kanë tërhequr kontributet e derdhura në arkën e kompensimit në Zvicër, të tjerët kanë vdekur dhe trashëgimtarët nuk kanë përfituar nga pensionet e veçorisë në mungesë të marrëveshjes.

## Kërkesa për riaktivizimin e zbatimit të marrëveshjes me ish Jugosllavinë

Njoftimet për arrijten e marrëveshjes janë konfidenciale dhe përpos mundësisë për eksportimin e pensioneve në Kosovë nuk shpalosin shumë nga përmbajtja. Por ajo që dihet nga Informacionet për të prekurit të publikuar në faqen e Entit federal për Sigurime Shoqërore të Zvicrës më 24 shkurt 2017 është se marrëveshja hyn në fuqi pas ratifikimit nga dy vendet përkatëse dhe përfitimet janë të mundshme vetëm pas hyrjes në fuqi të saj duke përjashtuar kështu përfitimet retroaktive.

Tanimë është gjithashtu e ditur se Marrëveshja e re e Sigurisë ndërshtetërore në mes të Zvicrës dhe Kosovës nuk përmbanë zgjidhje kalimtare për të mundësuar së paku pensionet për shtetasit të cilët deri tani kanë fituar të drejtën në pensione të invaliditetit pleqërisë e veçorisë por në mungesë të marrëveshjes nuk kanë pasur mundësi të përfitojnë. Të gjitha palët e përfshira arsyetojnë këtë se në mes të Zvicrës dhe Kosovës nga prilli i vitit 2010 nuk ekziston më marrëveshje dhe nuk është i mundur zbatimi i një marrëveshjeje e cila ka përfunduar zë zbatuar në fund të muajit mars 20110. Duke u bazuar në arsyet e përmendura të ndërprerjes së zbatimit të marrëveshjes së vjetër me ish Jugosllavinë si dhe mënjanimin e tërësishëm të këtyre arsyeve me nënshkrimin e marrëveshjes së re kërkesa për vazhdimin e kësaj marrëveshjeje nga autoritetet e Kosovës drejtuar ministrisë sociale të Zvicrës është e domosdoshme, e arsyeshme dhe e drejtë.

## Domosdoshmëria e informimit të personave të prekur

Me nënshkrimin e marrëveshjes fillon një etapë e re për Sigurinë Shoqërore në Kosovë. Kjo përvojë duhet të shërbejë si bazë në njërin anë për vërjen e themeleve për një sistem të ri Sigurisë Shoqërore në Kosovë duke përfshirë edhe rreziqet e reja sociale si sëmundjen, fatkeqësinë, papunësinë, amësinë etj., ndërsa në anën tjetër duhet ruajtur e kultivuar për arrijten marrëveshjeje të reja edhe me shtetet tjera ku banojnë e jetojnë shtetasit nga Kosova. Por në këtë proces nuk duhet harruar personat e prekur. Është më së urgjente që personat e prekur të informohen nga autoritetet e Kosovës për të drejtat dhe mundësitë e tyre të veprimtimit pas nënshkrimit të marrëveshjes.

## Angazhimet këmbëngulëse që rezultuan me marrëveshje

Angazhimi i mërgatës në Zvicër në këtë proces e ka zanafillën më 3 nëntor të vitit 204 me parashtrimin e kërkesës ministrisë së punës dhe mirëqenies sociale të Kosovës për ngritjen e kapaciteteve zbatuese të marrëveshjes në fuqi dhe për të paraqitur kërkesën autoriteteve Zvicerane për një marrëveshje të re ndërshtetërore të sigurisë Shoqërore me Zvicrën dhe Kosovës. Nuk është e arsyeshme as të mohohen e as të mëvetësohen këto angazhime por duhet të shërbejnë si reflektim dhe përvoja për vazhdimësi të angazhimeve në të ardhmen. Ky angazhim sigurisht se nuk përfundon me nënshkrimin e marrëveshjes. Angazhimi profesional e publik ka vazhduar pa ndërprerje duke zhvilluar aktivitete e takime me të gjitha palët e nivelet si dhe angazhimi intensiv i autoriteteve të Kosovës gjatë dy viteve të fundit përbëjnë mozaikun e kësaj arrijte historike. Parashtrimi i kërkesës për riaktivizimin e marrëveshjes paraqet domosdoshmërinë për kthimin e dinjitetit të ish sezonierëve nga Kosova. Arritja e zgjidhjes kalimtare për personat e prekur duke e riaktivizuar marrëveshjen e vjetër deri sa të hyjë në fuqi marrëveshja e re do të përmblynte këtë mozaik angazhimesh në njërin anë ndërsa në anën tjetër do të përforconte fundamentin për ngrehinën e qëndrueshmë të Sigurisë Shoqërore të shtetasve nga Kosova.

Ruzhdi Ibrahim dhe Osman Osmani

## Ju pyesni, Unia përgjigjet



### Mungesa e sigurimit aksidental: A

#### duhet unë vetë të paguajë shpenzimet?

Unë punoj dy ditë në javë si shitës në një dyqan gjësendesh antike. Tani unë në shtëpi gjatë pastrimit të dhomës së gjumit jam rrëzuar nga karrigia dhe me këtë rast kam thyer ashtin e këmbës së majtë. Mjeku më ka dhënë pushim mjekësor dhe dëshmi për paaftësi pune dy javore. Pyetjes së tij për sigurimin përgjigjes të invaliditetit, mjerisht nuk dita ti përgjigjem. Prandaj kam pyetur shefen time. Ajo ishte mendimit se për këtë duhej të përgjigjej arka e sigurimit tim privat shëndetësor. Pasi që ajo në dyqanin e saj mundëson vetëm punësim të pjesshëm, ajo nuk e ka pas

**PETER SCHMID:** Jo. Në Zvicër të gjithë punëmarrësit/et janë detyrimisht të siguruar në rast aksidenti në vendin e punës dhe rrugës për në punë. Për aksidentet e ashtuquajtura joprofessionale, të cilat ndodhin jashtë orarit të punës, të punësuarit e pjesshëm janë detyrimisht të siguruar nga punëdhënësi, nëse orari minimal i punës javorë është më së paku 8 orë. Kjo është kështu edhe në rastin e juaj. Shefja juaj duhet të kontrakttojë një sigurim gjegjës aksidental të Suva apo ndonjë tjetër.

Këtë obligim ligjor e ka shkelur shefja juaj. Mirëpo, nga kjo, ju fatmirësisht nuk i bartni dëmet financiare. Pikërisht për raste të tilla legjislativi ka krijuar një «arkë zëvendësuese». Të gjitha sigurimet aksidentale paguajnë një pjesë të caktuar të ardhurave nga premitë në këtë arkë. Kjo arkë zëvendësuese merre përsipër shpenzimet ligjore për punëmarrësit e pasiguruar në rast aksidenti. Më vonë kjo arkë e tërheqë më vonë nga punëdhënësit e gabuar preminë e caktuar zëvendësuese. Nëse punëdhënësi edhe përkundër vërejtjes së tërhequr nuk siguron punëmarrësit e saj, atëherë arka zëvendësuese ja përcakton detyrimisht një institucion të sigurimit të invaliditetit. Më shumë informata për këtë çështje mund të gjeni në internet tek: [www.ersatzkasse.ch](http://www.ersatzkasse.ch). Këtu pos tjerash mundeni që online të lajmëroni aksidentin tuaj.

work, 11.05.2017

### Pushimet vjetore:

#### Kur mund të jenë ato?

Në kontratën e marrëdhënies së punës time qëndron se, unë mund të marrë pushimet vjetore gjatë vitit kalendarik, më së voni deri në mars të vitit vijues. A shlyhen nëse nuk i tërheqë deri atëherë?

**MYRIAM MUFF:** Jo. Rregullimi kontraktues, sipas të cilit e drejta e pushimit vjetor humbet, nëse deri në kohën e caktuar nuk e keni shfrytëzuar, ligjërisht është e papranueshme dhe kështu edhe e pa ndikim. E drejta e shfrytëzimit të pushimit vjetor vjetohet apo humbet tek pas 5 vitesh. Kjo nuk vlen vetëm pas përfundimit të marrëdhënies së punës, por për gjithë vitet në shërbim, gjegjësisht vitet kalendarike. Në thelb vlen me sa vijon: Punëdhënësi duhet të mundëson «sipas rregullit» shfrytëzimin e pushimit vjetor përgjatë vitit shërbyes, kështu qëndron në të drejtën obliguese. Është punëdhënësi ai që përcakton kohën e shfrytëzimit të pushimit vjetor, edhe pse ai duhet të ketë parasysh aq sa është e mundur dëshirën dhe nevojat e punëmarrësit. Pra nuk është fare në përgjigjesi të punëmarrësit që të shfrytëzohet njëanshëm pushimi vjetor. Sipas ligjit lejohet përjashtimi nga rregulli, që një pjesë e pushimit të shfrytëzohet në vitin vijues. Mirëpo kjo në të vërtetë do të duhej të mbetej përjashtim, pasi pushimet vjetore e plotësojnë funksionin e tyre, nëse i shërbejnë pushimit, relaksimit dhe regjenerimit të rregullt e faktik, dhe mundësisht për çdo vit radhazi.

WORK, 01.06.2017

Impressum: Beilage zu den Gewerkschaftszeitungen work, area, Événement syndical | Herausgeber work, Gewerkschaft Unia, Chefredaktion: Marie-José Kuhn; Événement syndical SA, Lausanne, Chefredaktion: Sylviane Herranz; Edizioni Sociali SA, Lugano, Chefredaktion: Claudio Carrer | Redaktionskommission A. García, A. Rogalewski, D. Filipovic, E. Sariaslan, M. Martin, M. Mendes, O. Osmani | Sprachverantwortlich Dara Filipovic | Layout I. Schmieler, Unia | Druck Tagblatt Print, Im Feld 6, 9015 St. Gallen | Adresse Unia Redaktion «Horizonte», Weltpoststrasse 20, 3000 Bern 15, [darinka.filipovic@unia.ch](mailto:darinka.filipovic@unia.ch)



Die Gewerkschaft.  
Le Syndicat.  
Il Sindacato.

www.unia.ch